



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT

Nr. 577/1 prot.

Tiranë më 13.03.2024

Lënda: Dhënie mendimi mbi një projektligj.

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 2148 prot., datë 27.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 577 prot., datë 27.02.2024, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektligjin “Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve” si dhe dokumentet shoqëruese.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së projektligjit dhe dokumenteve shoqëruese vërejmë se projektligji ka si qëllim ngritjen e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve (ZRA), si autoritet kombëtar dhe strukturë e posaçme qendrore, e cila është përgjegjëse për procesin e gjurmimit dhe identifikimit të të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një veprë penale ose veprimtari kriminale, të cilat mund t’i nënshtrohen ngrirjes së përkohshme, sekuestrimit ose konfiskimit nga organet kompetente.

Gjithashtu, me anë të Tabelave të Përputhshmërisë (ToC), bashkëlidhur shkresës suaj, konstatojmë se me këtë projektligj synohet përafrim i plotë me Direktivën (BE) 2014/42, Direktivën (BE) 2019/1153, Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian 2007/845/JHA si dhe Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian 2007/845/JHA, si pjesë e përmbushjes së detyrimeve të Planit Kombëtar për Integrim Evropian, për Kapitullin 24 “Liria, Drejtësia dhe Siguria”.

Harmonizimi i projektligjit “Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve” me legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale, është një detyrim shumë i rëndësishëm duke pasur parasysh jo vetëm proceset përpunuese të të dhënave personale që parashikon nga ky projektligj, por edhe rëndësinë e zbatimit të legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale, i cili aktualisht është në një proces tejet të rëndësishëm, si ai i përafrimit të plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian,

konkretisht Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR) dhe Direktivën e (BE) 680/2016.

***Nga përmbajtja në tërësi e projektligjit***, vërejmë disa dispozita të cilat lidhen me procese përpunimi të të dhënave personale, për këtë arsye, Zyra e Komisionerit vlerëson domosdoshmërinë e angazhimit të nismëtarëve të tij për të përmbushur kërkesat lidhur me garantimin dhe respektimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuar edhe në nenin 35 të Kushtetutës.

Në mënyrë që përpunimi të konsiderohet i ligjshëm, duhet të jetë në përputhje me parashikimet e neneve 5 dhe 6 të Ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim “Ligji”), në të cilët janë përcaktuar parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave personale.

Referuar nenit 27 të Ligjit, vlerësojmë se në projektligj duhet të parashikohet marrja e masave teknike dhe organizative të sigurisë për të garantuar standardet më të larta gjatë përpunimit të të dhënave personale nga autoritete kompetente. *(Ky sugjerim vjen në linjë, me pikën 5, të nenit 3, të Direktivës (BE) 2019/1153).*

Gjithashtu, në këtë projektligj nuk gjejmë të parashikuar rregullime mbi nivelin dhe monitorimin e aksesit në databazat përkatëse. Monitorimi i aksesit dhe kërkimeve nga autoritetet kompetente është i rëndësishëm, pasi çdo institucion, në cilësinë e kontrolluesit në kuptim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, legjitimohet të aksesojë të dhëna personale, vetëm për aq sa lidhet me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së tij.

Nga ana tjetër, për përmbushjen e këtij kriteri të ligjshëm përpunimi, është e nevojshme që databaza e të dhënave të ndërtohet në mënyrë të tillë që të garantohet konfidencialiteti dhe akses i kufizuar në përputhje me qëllimin e përpunimit si dhe të sigurohet gjurmueshmëria për çdo ndërhyrje në databazat përkatëse. *(Ky sugjerim vjen në linjë me nenin 6, të Direktivës (BE) 2019/1153, i cili nga ToC përkatëse rezulton jo i përafshuar).*

Sa i përket krijimit të “*Bazës së të dhënave dhe informacionit statistikor*” mendojmë që duhet të rishikohet sa i përket llojit dhe sasisë së informacionit që do të përmbajë. Referuar ToC përkatëse e cila përafshon nenin 25 të projektligjit, me nenin 17 të Direktivës (BE) 2019/1153, ky përafshim rezulton që nuk është i plotë dhe në të nuk parashikohet një paragraf mbi afatin kohor të ruajtjes së të dhënave personale apo informacionit.

Caktimi i një afati kohor mbi ruajtjen e të dhënave përbën një nga kriteret bazë në zbatim të germës d), të nenit 5 të Ligjit sipas së cilit parashikohet që mbrojtja e të dhënave personale bazohet në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej. *(Ky sugjerim vjen në linjë me nenin 17, të Direktivës (BE) 2019/1153, ku parashikohet afati 5 - vjeçar).*

Për sa i përket, ***neneve specifike të projektligjit***, sugjerojmë që Neni 14 i projektligjit të riformulohet si vijon:

**Neni 14**  
**Përpunimi dhe konfidencialiteti i të dhënave personale**

1. *Përpunimi i të dhënave personale (përfshirë edhe ato sensitive) do të kryhet në përputhje me parimet, kriteret, si dhe masat tekniko-organizative të zbatueshme për garantimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. (Përafruar dhe me nenin 5 (3) dhe 16 (1) të Direktivës (BE) 2019/1153).*
2. *Vetëm personat e autorizuar dhe të trajnuar nga ZRA mund të kenë akses në përpunimin e të dhënave personale dhe detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit që kryejnë, sipas qëllimeve të këtij ligji. (Përafruar dhe me nenin 16 (2) Direktivës (BE) 2019/1153).*

Me reflektimin e propozimeve të mësipërme, ky projektligj do të konsiderohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**